

Projekti i USAID-it për përforsimin e kapaciteteve për shfrytëzim të resurseve  
Programi i profesionistëve të rinj

Projekti i USAID-it për përforsim të kapaciteteve për shfrytëzim të resurseve kërkon profesionistë të rinj ose studentë të motivuar, të organizuar dhe të përkushtuar ndaj rezultateve, të ciklit deridiplomik/pasdiplomik, të cilët do të shërbejnë si **praktikantë në njërin nga komunat partnere: Studeniçan, Qendër Zhupë, Staro Nagoriçane, Vrapçisht dhe Mogillë**. Ai/ajo do të punojë ngushtë me departamentin e administratës tatimore dhe do të kryejë detyrat e mbledhjes dhe analizës së të dhënave.

Projekti mbështet komunat partnere për të rritur kapacitetin e tyre për mbledhjen e të hyrave nga burimet e tyre, qasjen në burime të jashtme për financim dhe planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit.

Profesionistët e rinj të përzgjedhur do të kontraktohen nga Projekti për të ofruar mbështetje për komunën që ai/ajo preferon në përditësimin dhe përmirësimin e bazës aktuale të të dhënave të tatimit në pronë dhe tarifave komunale, si dhe të gjithë sistemit të administrimit tatimor, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

- Aktivitete në zyrë dhe në terren për identifikimin dhe regjistrimin e të gjitha pasurive të paluajtshme
- Azhurnimin e të dhënave në sistemin e administrimit të tatimeve lokale.
- Mbështetje për departamentin e administratës tatimore në përgatitjen/plotësimin e formularëve të administratës tatimore në përputhje me ligjin për tatimin në pronë dhe tarifatat komunale.
- Kontribut në fushatën publike lokale për rritjen e motivimit të taksapaguesve për të paguar taksat dhe për t'u informuar se si shpenzohen paratë e tyre.
- Detyra të tjera të ngarkuara nga Kryetari dhe/ose udhëheqësi i njësisë së tatimeve.

Profesionistët e rinj do të marrin trajnim fillestar dhe mentorim të vazhdueshëm nga ekipi i Projektit. Kohëzgjatja e Programit të Profesionistëve të Rinj është gjashtë muaj.

Përgatitja e dëshiruar arsimore është nga shkencat teknike, administrimi publik ose i biznesit ose ekonomia. Angazhimi do të negociohet për 6-8 orë në ditë pune me kompensimin adekuat. Shpenzimet e transportit nuk do të mbulohen.

Kandidatët e interesuar pritët të dërgojnë CV dhe letër motivuese deri më datë 28.12.2021 në [info@srmamk.com](mailto:info@srmamk.com) duke specifikuar emrin e komunës për të cilën ata janë të interesuar.